VENDIM
Nr. 60, datë 19.9.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 19.9.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (H) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Haki Kosta, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokati Marash Logu.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 6, datë 25.5.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës të Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative me nr. 31147-02191-86-2018, datë regjistrimi 4.6.2018, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda një afati kohor të caktuar sa më të afërt.

SUBJEKT I INTERESUAR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve shoqërore Tiranë

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 399/1 e vijuese të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*; nenet 3 dhe 48, pika 2, i ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012);* nenet 71 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(ligji nr. 8577/2000)*.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës*,* konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Haki Kosta (*kërkuesi*) ka ushtruar detyrën e minatorit të nëntokës në minierën Valias, Kërrabë dhe Mushqeta. Me vendimin nr. 1279, datë 30.10.2001, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH*) Tiranë, ai është shpallur përfitues i pensionit të parakohshëm "*trajtim i veçantë minatori*", bazuar në ligjin nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në nëntokë" *(ligji nr. 8685/2000)* me të drejtë pagese nga data 16.12.2000 deri në mbushjen e moshës për pension pleqërie.

2. Me miratimin e ligjit nr. 150, datë 6.11.2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë" *(ligji nr. 150/2014*), kërkuesi ka paraqitur kërkesën nr. 405, datë 23.1.2015 pranë DRSSH-së, Tiranë për përfitimin e pensionit të pleqërisë.

3. Pasi ka verifikuar kërkesën, DRSSH-ja, Tiranë ka vlerësuar se kërkuesi nuk plotësonte kushtet e parashikuara në nenin 2 të ligjit nr. 8685/2000 dhe me aktin administrativ nr. D, datë 16.6.2015, "Për mbyllje pensioni", si dhe vendimin nr. 195, datë 25.1.2018, "Për mbylljen e trajtimit të veçantë, caktimin e masës debitor dhe refuzimin e së drejtës për përfitim pensioni pleqërie sipas ligjit nr. 150/2014", ka vendosur mbylljen e pensionit të caktuar me vendimin nr. 1279, datë 30.10.2001 dhe refuzimin e kërkesës për përfitim pensioni sipas ligjit nr. 150/2014, duke e shpallur kërkuesin debitor në shumën 1.108.991 lekë.

4. Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje, kërkuesi në datën 12.2.2018 i është drejtuar gjykatës administrative me kërkesëpadi me objekt: *"Shfuqizimin e vendimit nr. D. datë 16.6.2015, vendimit të shpalljes debitor të përfitimit të pensionit si trajtim i veçantë minatori për periudhën 16.12.2000-30.5.2015 në shumën 1.108.991 lekë, njoftuar me vendimin nr. 195, datë 25.1.2018. Detyrimin e palës, DRSSH-së, t'i caktojë atij pensionin e pleqërisë si minator i nëntokës nga data e kërkesës 23.1.2015 e në vazhdim.".*

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1370, datë 16.4.2018, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, anulimin e aktit administrativ vendimit për mbyllje pensioni, nr. D, datë 16.6.2015 dhe shpalljen debitor të kërkuesit. Anulimin e vendimit 195, datë 25.1.2018 "Për mbylljen e trajtimit të veçantë, caktimin e masës debitor dhe refuzimin e së drejtës për përfitim pensioni pleqërie sipas ligjit nr. 150/2014", si dhe detyrimin e palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, që t`i caktojë dhe paguajë paditësit pensionin e pleqërisë në bazë të ligjit nr. 150/2014, me të drejtë përfitimi prej datës së lindjes të së drejtës.

6. Mbi bazën e ankimit të datës 19.4.2018, të palës së paditur, DRSSH-së, Tiranë, çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31147-02191-86-2018 regjistrimi, datë 4.6.2018.

7. Në kushtet kur kishte kaluar një periudhë e gjatë nga regjistrimi i çështjes së tij dhe nga gjykata e apelit nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim, në datën 2.12.2022 kërkuesi i është drejtuar gjyqtarit relator duke kërkuar përshpejtimin e gjykimit.

8. Duke mos marrë përgjigje në lidhje me kërkesën e depozituar, kërkuesi në datën 16.2.2023, bazuar në nenet 399/1 e vijuese të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit.

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 6, datë 25.5.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive dhe se nuk ka zvarritje të qëllimshme nga gjyqtari relator, por në kuptim të nenit 399/2 të KPC-së, ajo gjykatë ka qenë në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë, pasoja këto të reformës në drejtësi. Vendimi i është komunikuar kërkuesit në datën 25.10.2023.

10. Në datën 17.1.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës në datën 12.3.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi çështja e tij e regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit ka mbi 5 vjet që nuk shqyrtohet, duke iu referuar momentit të regjistrimit të saj, datë 4.6.2018, duke tejkaluar kështu afatin kohor të arsyeshëm të gjykimit. Kërkuesi është në një moshë relativisht të madhe, 67 vjeç, dhe gjykatat duhet të tregojnë kujdes të veçantë në raste të tilla.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

14. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur fillimisht kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, drejtuar gjyqtarit relator të çështjes së tij në pritje të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe më pas, në zbatim të neneve 399/5 - 399/6 të KPC-së, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kolegji Administrativ me vendimin nr. 6, datë 25.5.2023. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion i kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 25.5.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.1.2024 dhe pasi është plotësuar me dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata është regjistruar në datën 17.1.2024. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesi, vendimi i kundërshtuar është bërë i disponueshëm për të në datën 25.10.2023, kur i është komunikuar nga Gjykata e Lartë përmes shërbimit postar, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, për shkak të mosgjykimit të çështjes së tij nga gjykata e apelit brenda afatit të arsyeshëm, pretendim i cili në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

18. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi shqyrtimi i çështjes së tij në Gjykatën Administrative të Apelit ka mbi 5 vjet që nuk shqyrtohet nga momenti i regjistrimit të

saj, datë 4.6.2018, duke u tejkaluar kështu afati kohor i arsyeshëm i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja "b", të KPC-së. Kërkuesi është në një moshë relativisht të madhe, 67 vjeç, dhe gjykatat duhet të tregojnë kujdes të veçantë në raste të tilla.

19. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Gjykata vëren se në rastin konkret mosmarrëveshja që po gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me një mjet të domosdoshëm të jetesës, siç është e drejta e pensionit. Procesi gjyqësor ka filluar në gjykatën e shkallës së parë në datën 12.2.2018, data e regjistrimit dhe pas dhënies së vendimit të datës 16.4.2018 nga gjykata administrative e shkallës së parë, në favor të kërkuesit, pala e paditur, DRSSH-ja, Tiranë, ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 4.6.2018 dhe ndonëse kanë kaluar mbi 5 vjet ende nuk ka një vendimmarrje në lidhje me themelin e saj.

21. Sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja "a", të KPC-së, përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit administrativ në gjykatën e apelit brenda një viti. Kjo do të thotë se gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgjatur, ndaj për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuesit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në lidhje me *sjelljen e kërkuesit*, Gjykata vëren se ai, pasi ka konstatuar se nuk ishte planifikuar datë për shqyrtimin e çështjes së tij të regjistruar në datën 4.6.2018 në Gjykatën Administrative të Apelit, mbi bazën e ankimit të DRSSH-së, Tiranë, në datën 2.12.2022 i është drejtuar relatorit të çështjes për përshpejtimin e gjykimit dhe, më pas, në datën 16.2.2023, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë në datën 25.5.2023 dhe sërish çështja ka mbetur pa veprime, në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Kërkuesi, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

23. Për sa i takon *kompleksitetit të çështjes,* Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative dhe kërkesëpadia ka në objekt të saj dy kërkime që lidhen ndërmjet tyre, atë të anulimit të aktit administrativ vendimit nr. D, datë 16.5.2015 për mbylljen e pensionit të caktuar me vendimin nr. 1279, datë 30.10.2001, bazuar në ligjin nr. 8685/2000, sipas të cilit kërkuesi është shpallur debitor, si dhe përfitimin e pensionit të pleqërisë si minator i nëntokës. Gjykata administrative e shkallës së parë ka vendosur të pranojë kërkesëpadinë dhe kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DRSSH-ja, Tiranë, e cila ka pretenduar se kërkuesi nuk plotëson kriterin për vjetërsinë në nëntokë dhe se përfitimi i trajtimit të veçantë si ish-minator i nëntokës është i padrejtë, pasi nuk plotëson kushtin e vjetërsisë totale prej 23 vjetësh. Duke iu referuar aspekteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse e tillë që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej më shumë se 5 vjetësh në gjykatën e apelit.

24. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë për sa është theksuar nga Gjykata e Lartë për situatën aktuale të ngarkesës së sistemin gjyqësor, Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit tashmë prej më shume se 5 vjetësh, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në ligjin nr. 49/2012 dhe KPC, gjithashtu nga KLGJ-ja çështje të tilla janë vlerësuar se duhet të shqyrtohen shpejt për

të shmangur pasojat e rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë (*shih kreun II, pika 3, nënpika 3.1., shkronja "g", të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të KLGJ-së, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit").* Nga informacioni i kërkuar nga Gjykata e Lartë, sikurse arsyeton Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave, relatori i çështjes, nëpërmjet shkresës nr. 1463/1, datë 8.3.2023, ka parashtruar se ka 3800 çështje që presin të shqyrtohen dhe se për shqyrtimin e tyre duhet të zbatohet rendi kronologjik. Çështja i ka kaluar për shqyrtim me shortin e datës 30.4.2021, pas largimit nga detyra të relatorit të mëparshëm. Këshilli i Gjykatës së Apelit Administrativ ka disponuar përsëri me vendimin nr. 49, datë 24.2.2023, "Për rishortimin me short të çështjeve", të regjistruara në periudhën 2017–2023, diktuar nga përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë të një gjyqtari të asaj gjykate. Në vijim, për shkak të ndryshimit të gjyqtarit relator, Gjykata e Lartë ka kërkuar sërish mendim nga relatori i shortuar, i cili me shkresën nr. 697/1, datë 4.5.2023, ka parashtruar se në zbatim të vendimit të KLGJ-së, me shortin e datës 7.3.2023, çështja në fjalë i është caktuar për gjykim dhe se tashmë nga kjo gjykatë janë përfunduar çështjet e vitit 2016 dhe është vijuar me ato të vitit 2017. Po kështu, ai parashtron se ka në shqyrtim edhe çështje të cilat kanë vijuar me procedurat e përshpejtimit sipas rasteve që parashikon ligji dhe aktet nënligjore të KLGJ-së. Pamundësia e gjykimit rrjedh nga fakti se kjo gjykatë funksionon me një numër të pakët gjyqtarësh dhe si relator ka 3346 çështje në ngarkim.. Nga informacioni i kërkuar nga Gjykata në lidhje me statusin aktual të çështjes së kërkuesit, rezulton se çështja është rishortuar sërish dhe deri në datën 12.9.2024 ende nuk ka një datë planifikimi për shqyrtimin e saj.

25. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi,* Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa "*vetjakë e jetësorë*", duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuesit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti *(shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese).*

26. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se rrethanat e kërkuesit janë të veçanta. Ai është ish-minator i nëntokës dhe aktualisht është në moshën 67 vjeç. Çështja e tij lidhet me një mjet të domosdoshëm të jetesës, siç është e drejta e pensionit si ish-minator i nëntokës. Vetë KLGJ-ja në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, i ka vlerësuar çështjet e përfitimit të pensionit me natyrë specifike të cilat duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë *(shih kreun II, pika 3, nënpika 3.1., shkronja "g", të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të KLGJ-së, "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit").* Edhe GJEDNJ-ja ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë "kujdes të veçantë" ose "kujdes të jashtëzakonshëm", të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj.

27. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej standardeve të lartpërmendura kushtetuese, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret tejzgjatja e procedurave gjyqësore prej më shumë se 5 vjetësh për shqyrtimin e një çështjeje të tillë paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuesit.

28. Në përfundim, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej më shumë se 5 vjetësh të shqyrtimit të ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, kompleksitetin e ulët të çështjes, sjelljen e autoriteteve, si dhe rëndësinë e së drejtës së pensionit, Gjykata vlerëson se kërkuesit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit, ndaj kërkesa duhet të pranohet.

29. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës së Gjykatës Administrative të Apelit dhe volumin e çështjeve të ngjashme me ato të kërkuesit, Gjykata çmon se duhet urdhëruar shqyrtimi i ankimit brenda 6 muajve për çështjen e kërkuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 25.5.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit të gjykojë çështjen e kërkuesit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.9.2024.
Shpallur më 7.10.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE (PJESËRISHT)

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes, që i përket kërkuesit Haki Kosta, me objekt: *"Shfuqizimi i vendimit nr. 6, datë 25.5.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës të Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative me nr. 31147-02191-86-2018, me datë regjistrimi 4.6.2018, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda një afati kohor të caktuar sa më të afërt",* ne, gjyqtarët në pakicë, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica vetëm për sa i përket afatit të përcaktuar në pikën 4 të dispozitivit të vendimit, për të cilin mendojmë se Gjykata duhet të shprehej për gjykimin me përparësi të çështjes së kërkuesit nga Gjykata Administrative e Apelit.

2. Fillimisht, çmojmë të theksojmë se bashkohemi me shumicën në lidhje me vlerësimin e kritereve dhe përfundimin e arritur në drejtim të tejzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, sikundër edhe për sa u përket masave që ajo gjykatë duhet të marrë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së kërkuesit, duke ndarë qëndrim të ndryshëm vetëm për sa i përket afatit të përcaktuar për ndërmarrjen e tyre, konkretisht atij sipas pikës 4 të dispozitivit të vendimit, ku është urdhëruar detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen e kërkuesit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit.

3. Së pari, mendojmë se përcaktimi i afateve konkrete për marrjen e masave përshpejtuese të procedurave (gjyqësore, hetimore ose të ekzekutimit) kapërcen natyrën konstatuese të shkeljeve të gjykimit kushtetues. Në këtë pikëpamje, vlerësojmë se konstatimi i shkeljes së kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurave nga Gjykata është i mjaftueshëm për të imponuar vënien në lëvizje të mekanizmave të tjerë të paraparë nga ligji për korrigjimin e shkeljes, ndër to edhe përshpejtimi i procedurave nga organi që ka kryer shkeljen, ndërsa vendimet e saj në bazë të nenit 132 të Kushtetutës janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

4. Së dyti, përtej kësaj, mendojmë se një qasje e tillë e shumicës për sa i përket përcaktimit të afatit për marrjen e masave përshpejtuese nga gjykata që ka kryer shkeljen në rastin konkret, nuk merr në konsideratë situatën e saj konkrete dhe as të sistemit gjyqësor në përgjithësi, ndërsa është fakt i njohur publikisht mbingarkesa e gjyqtarëve dhe numri i reduktuar i tyre, në veçanti në gjykatën në fjalë, sikurse evidentohet edhe nga të dhënat e administruara gjatë shqyrtimit. Pavarësisht se një situatë e tillë nuk mund të përbëjë justifikim për tejzgjatjen e paarsyeshme të gjykimeve, sidomos të atyre me natyrë të veçantë, mendojmë se ajo nuk mund të injorohet për sa u përket afateve për marrjen e masave përshpejtuese. Në vlerësimin tonë, duke i vendosur gjykatës

në shkelje afatin 6-mujor për shqyrtimin e çështjes së kërkuesit, shumica nuk ka reflektuar qasjen e duhur as mbi efektivitetin e vendimeve të Gjykatës dhe as mbi mundësinë reale të asaj gjykate për shqyrtimin e çështjes, dhe shmangien e situatave që mund të ngrenë problematika të natyrës kushtetuese. Në këtë drejtim, shumica parashtron se mban në konsideratë ngarkesën e punës së gjykatës dhe volumin e çështjeve të ngjashme me atë të kërkuesit *(shih paragrafin 29 të vendimit),* por pa treguar dhe pa analizuar të dhënat konkrete për këto aspekte në kuptimin që pikërisht ai është afati i duhur për korrigjimin e shkeljes, ndërsa u përgjigjet kushteve dhe mundësive të asaj gjykate (gjyqtarit relator) për të vepruar në çështjen e kërkuesit, sikundër as nuk e shtyn atë gjykatë në trajtimin jo të barabartë të individëve që kanë çështje të ngjashme dhe të regjistruara para asaj të kërkuesit, të cilët mund të ndodhen në të njëjtat kushte ose edhe më të përligjura se ai në pikëpamje të kohëzgjatjes së procedurave të gjykimit.

5. Për sa më lart, vetëm me qëllimin për të qartësuar atë çka imponon konstatimi i shkeljes së kohëzgjatjes së arsyeshme nga Gjykata në pikëpamje të korrigjimit të saj përmes përshpejtimit të procedurës, si dhe në koherencë me qasjen e Gjykatës në disa raste të kësaj natyre *(shih vendimet nr. 27, datë 11.4.2024; nr. 6, datë 15.2.2024; nr. 61, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese),* mbajtëm qëndrimin dhe votuam për detyrimin e gjykatës së zakonshme në shkelje për gjykimin e çështjes së kërkuesit me përparësi.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtar: Ilir Toska